



Water and Waste Regulatory Office  
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina  
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad



ZRRUM-R 02 / W&WW

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA

---

**RREGULL**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT**

**NGA**

**OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA SI DHE  
FURNIZUESIT E UJIT ME SHUMICË NË KOSOVË**

26 Janar 2005

## PËRMBAJTJA

<b>PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b> .....	4
<b>Kapitulli 1: Dispozitat e Përgjithshme</b> .....	4
Neni 1: Autoriteti i këtij Rregulli .....	4
Neni 2: Përfshirja .....	4
Neni 3: Qëllimi .....	4
Neni 4: Definicionet .....	4
Neni 5: Regullat e Interpretimit .....	7
Neni 6: Përfshirja .....	7
<b>PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME PËR VËNIEN E TARIFAVE</b> .....	8
<b>Kapitulli 2: Parimet e Përgjithshme</b> .....	8
Neni 7: Parimet e Përgjithshme për Tarifat e Shërbimeve .....	8
Neni 8: Zbatueshmëria e Tarifave të Shërbimit brenda Zonës së Shërbimit .....	8
Neni 9: Kategoritë e Konsumatorëve Për Rregullimine Tarifave për Shërbime .....	9
<b>Kapitulli 3: Metodatat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit</b> .....	9
Neni 10: Metodatat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit .....	9
<b>Kapitulli 4: Vendosja e Tarifave të Shërbimit</b> .....	9
Neni 11: Vendosja e Tarifave të Shërbimit .....	9
<b>PJESA III: LLOGARTIJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT SIPAS METODËS PËR RIGJENERIMIN E KOSTOS PËR SHËRBIMET PËR UJË</b> .....	10
<b>Kapitulli 5: Hapat për Llogaritjen e Tarifave për Shërbime</b> .....	10
Neni 12: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit të Ujit .....	10
<b>Kapitulli 6: Llogaritja e Kostos në Ofrimin e Shërbimeve</b> .....	10
Neni 13: Llogaritja e Kostos të Shërbimeve të Ofruara .....	10
Neni 14: Llogaritja e Shpenzimeve Operative .....	11
Neni 15: Kostot e Përfshirja nga Njehsimi i Shpenzimeve Operative .....	12
Neni 16: Kostot e Shërbimeve të Borxhit .....	12
Neni 17: Pranimi i Kontove të Pa-Inkasuara .....	12
Neni 18: Shpenzimet Kapitale .....	13
Neni 19: Përmbledhja e Kostove .....	13
<b>Kapitulli 7: Vlerësimi i të Hyrave të Kërkuara nga Operimet</b> .....	13
Neni 20: Vlerësimi i të Hyrave të Kërkuara nga Operimet .....	13
<b>Kapitulli 8: Llogaritja e Kostove të Ujit që duhet Shitur</b> .....	14
Neni 21: Llogaritja e Kostove të Ujit që duhet Shitur .....	14
Neni 22: Llogaritja e Kostos për Metër Kub të Ujit të Shitur .....	14
<b>Kapitulli 9: Llogaritja e Të Hyrave të Vlerësuara nga Operimet</b> .....	14
Neni 23: Llogaritja e Të Hyrave të Vlerësuara nga Operimet .....	14
Neni 24: Analizat e Ndjeshmërisë për të Hyrat e Vlerësuara nga Operimet .....	14
<b>Kapitulli 10: Llogaritja dhe Struktura e Tarifave të Shërbimit që i Propozohet Rregullatorit</b> .....	14
Neni 25: Llogaritja dhe Struktura e Tarifave të Shërbimit që i Propozohet Rregullatorit .....	14
Neni 26: Shuma për Faturimine Konsumatorët .....	15
<b>PJESA IV: LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT ME METODËN E MBULIMIT TË KOSTOS PËR SHËRBIMET E UJRAVE TË ZEZA</b> .....	15
<b>Kapitulli 11: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit të Ujërave të Zeza</b> .....	15
Neni 27: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit të Ujërave të Zeza .....	15
<b>PJESA V: LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT ME METODËN E MBULIMIT TË KOSTOS PËR UJIN ME SHUMICË</b> .....	16
<b>Kapitulli 12: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit për Ujin me Shumicë</b> .....	16
Neni 28: Llogaritja e Tarifave për Ujin me Shumicë .....	16
<b>PJESA VI: SHQYRTIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT</b> .....	17
<b>Kapitulli 13: Aplikimi, Shqyrtimi dhe Aprovimi i Tarifave të Shërbimit</b> .....	17
Neni 29: Aplikacioni për Tarifa të Shërbimit .....	17
Neni 30: Shqyrtimi nga Rregullatori i Aplikacioneve për Tarifa të Shërbimit .....	17
Neni 31: Aprovimi i Tarifave të Shërbimit .....	18

<b>Kapitulli 14: Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit</b> .....	18
Neni 32: Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit .....	18
<b>PJESA VII: KORRIGJIMET DHE RISHIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT</b> .....	19
<b>Kapitulli 15: Korrigjimet e Tarifave të Shërbimit</b> .....	19
Neni 33: Kërkesa për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit .....	19
Neni 34: Procedurat për Aprovimin e Korrigjimit të Tarifave të Shërbimit .....	19
Neni 35: Refuzimi i Korrigjimit të Tarifave të Shërbimit .....	20
<b>Kapitulli 16: Rishikimi i Tarifave të Shërbimit</b> .....	20
Neni 36 Shqyrtimi i Tarifave për Shërbime .....	20
<b>PJESA VIII: MARRËVESHJET PËR TARIFA</b> .....	21
<b>Kapitulli 17: Negociatat dhe Lidhja e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit</b> .....	21
Neni 37: Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit .....	21
Neni 38: Negocimi për Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit .....	22
Neni 39: Lidhja e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit .....	23
<b>Kapitulli 18: Natyra Ligjore dhe Fuqizimi i Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit</b> .....	23
Neni 40: Natyra Ligjore dhe Fuqizimi i Marrëveshjes së Tarifave për Shërbime .....	23
Neni 41: Pajtueshmëria me Marrëveshjen e Tarifave të Shërbimit .....	24
<b>PJESA IX: PUBLIKIMI I TARIFAVË TË SHËRBIMIT</b> .....	24
<b>Kapitulli 19: Prezentimi dhe Publikimi i Tarifave të Shërbimit</b> .....	24
Neni 42: Prezentimi i Tarifave të Shërbimit .....	24
Neni 43: Publikimi dhe Shpërndarja e Tarifave të Shërbimit .....	24
<b>PJESA X: ZBATIMI, GJOBAT DHE ANKESAT</b> .....	25
<b>Kapitulli 20: Zbatimi i Kushteve të Tarifave të Shërbimit</b> .....	25
Neni 44: Zbatimi i Kushteve të Tarifave për Shërbime .....	25
<b>Kapitulli 21: Regjistrat dhe Raportet për Kushtet e Tarifave të Shërbimit</b> .....	25
Neni 45: Vendndodhja dhe Disponueshmëria e Regjistrave .....	25
Neni 46: Raportet .....	25
Neni 47: Periudha e Mbajtjes së Shënimeve dhe Raporteve .....	25
<b>Kapitulli 22: Kundërvajtjet dhe Gjobat</b> .....	26
Neni 48: Kundërvajtjet dhe Gjobat .....	26
<b>Kapitulli 23: Ankesat</b> .....	26
Neni 49: Ankesat .....	26
<b>PJESA XI: TË NDRYSHME</b> .....	27
Neni 50: Gjuha Zyrtare e Rregullës .....	27
Neni 51: Hyrja në Fuqi .....	27
<b>SHTOJCA 1</b> .....	29
FORMULARI I APLIKACIONIT PËR TARIFA TË SHËRBIMIT PËR SHËRBIME TË UJIT DHE TË UJËRAVE TË ZEZA DHE PËR FURNIZIM TË UJIT ME SHUMICË .....	29
<b>SHTOJCA 2</b> .....	30
BASHKANGJITJET QË KËRKOHEN NGA APLIKUESIT PËR TARIFA TË SHËRBIMIT .....	30
<b>SHTOJCA 3</b> .....	31
TABELA PËR KALKULIMIN E TARIFAVE .....	31
<b>SHTOJCA 4</b> .....	44
TABELA PËR KALKULIMIN E TARIFAVE TË UJIT ME SHUMICË .....	44
<b>SHTOJCA 5</b> .....	53
METODA PËR KRIJIMIN E BLOQEVE TË SASISË .....	53
<b>SHTOJCA 6</b> .....	54
VLERAT E PARAMETRAVE QË DUHET TË PËRDOREN NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE UJËRAVE TË ZEZA PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT .....	54
<b>SHTOJCA 7</b> .....	55
KËRKESA PËR KORRIGJIM TË TARIFAVE .....	55

## **PJESA I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Kapitulli 1: Dispozitat e Përgjithshme**

#### **Neni 1: Autoriteti i këtij Rregulli**

Rregullatori lëshon këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina në Kosovë.

#### **Neni 2: Përfshirja**

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që aktualisht veprojnë në ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose në Furnizimin e Ujit me Shumicë në Kosovë duhet të i zbatojnë këto rregulla dhe procedura për zhvillimin, marrjen e aprovimit dhe ndryshimin e tarifave për shërbimet e ofruara.

#### **Neni 3: Qëllimi**

Qëllimi i këtij Rregulli është që të krijojnë rregullat dhe procedurat nën të cilat mund të përcaktimi dhe zbatimi i tarifave për furnizimin me ujë dhe për mbledhjen e ujërave të zeza, trajtimin dhe zbrazjen e tyre.

#### **Neni 4: Definicionet**

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull do të përmbajnë kuptimet si në vijim:

**Analizat e Ndjeshmërisë** nënkupton testin për të përcaktuar se si ndërrohen rezultatet e llogaritjes nëse do të ndërroheshin një ose më shumë supozime në të cilat është e bazuar llogaritja.

**Aplikacioni për Tarifë të Shërbimit** nënkupton dokumentin e dorëzuar nga Ofruesi i Shërbimeve tek Rregullatori në një format të specifikuar nga Rregullatori

**Ditë Pune** nënkupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dielës, apo ditë tjetër që është festë zyrtare në Kosovë;

**Efluent Industrial** nënkupton shkarkimin e kanalizimit nga Konsumatorët Jo-Shtëpiak në Sistemin për Mbledhjen e Ujërave të Zeza;

**Faturë** nënkupton njoftimin me shkrim për të paguar për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza, e cila saktëson shumën që është e caktuar për t'u paguar dhe është borxh, dhe periudhën gjatë së cilës janë ofruar shërbimet, të lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza tek Konsumatori në gjuhën Shqipe dhe Serbe;

**Furnizuesi i Ujit me Shumicë** nënkupton cilindo Person i cili furnizon Ujin me Shumicë tek Ofruesi i Shërbimeve për Ujë;

**Konsumator** nënkupton çdo person që ka lidhë Kontratën për Shërbime për Ujë dhe Ujëra të Zeza apo kontratën për Furnizim me Ujë me Shumicë që në mënyrë të ligjshme ka marrë Shërbime për Ujë të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve;

- i. **Konsuamtori Shtëpiak** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- ii. **Konsumatori Komercial/Industrial** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumatori i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- iii. **Konsumatori Institucional** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si oorganizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afarsite në Kosovë.

**Jetëzgjatja** nënkupton periudhën kohore të shprehur në vite gjatë së cilës asetet fikse mund të plotësojnë qëllimin për të cilin janë të dedikuara në mënyrë të duhur para se të ketë nevojë të zëvendësohen;

**Komisioni Shqyrtues** nënkupton komisionin i cili mund të shqyrtojë vendimet e Rregullatorit konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49;

**Konsumatori i Ujit me Shumicë** nënkupton individin dhe/ose personin ose subjektin ligjor i cili e blen Ujin me Shumicë nga Ofruesi i Shërbimeve me qëllim që ta shes atë tek cilado palë e tretë.

**Kontrata e Shërbimit** nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve dhe Konsumatorit të tij, dhe nëse nuk ekziston një marrëveshje e tillë atëherë nënkupton rregullat (dispozitat) për furnizim të Ofruesit të Shërbimeve;

**Kosto Variable** nënkupton kostot operative për paga, energji, kemikalje, materiale dhe gjëra tjera të cilat ndryshojnë me ndryshimin e vëllimit të ujit të prodhuar dhe të shpërndarë si dhe me ndryshimin e vëllimit të ujërave të zeza të mbledhura dhe të përpunuara;

**Lista e Tarifave të Shërbimit** nënkupton të gjitha Tarifat e aplikueshme të Shërbimeve për Zonën e Shërbimeve duke përfshirë tarifat sipas llojit të shërbimit, vendndodhjes dhe kategorisë së Konsumatorit dhe ngarkesat për Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza të ofruara tek Konsumatorët të cilat janë aprovuar nga Rregullatori

**Llogaritë e Papaguara** nënkupton asetet aktuale që përfaqësojnë parat që duhet të paguhet për për shërbimet e ofruara ose të ekzekutuara ose mallërat e shitura me kredit;

**Plani i Menaxhimit të Aseteve (Mjeteve Themelore)** nënkupton planin e shkruar të projekteve kapitale dhe shpenzimeve të tyre të llogaritura;

**Uji me Shumicë** nënkupton ujin i cili nuk është i përpunuar në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për konsum njerëzor;

**Ndërmarrje Shoqërore** ka kuptimin e njëjtë sikurse në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të 13 qershorit 2002 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, domethënë: Ndërmarrja e cila është krijuar si pronë shoqërore nën Ligjin për Ndërmarrje, Ligjin për Punën e Bashkuar të Republikës Federale të Jugosllavisë ose ndonjë ligj tjetër të aplikueshëm në Kosovë;

**Ofruesi i Shërbimeve** nënkupton cilindo Ofrues të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, ose Furnizuesin e Ujit me Shumicë, së bashku "Ofruesit e Shërbimeve"

**Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe të Ujërave të Zeza** nënkupton Personin që ofron apo që mendon të ofrojë Shërbime të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

**Person** nënkupton një individ, subjekt ligjor apo publik përfshirë korporatë, ortakëri, trust, organizatë të painkorporuar, një qeveri apo cilëndo agjenci apo nënsektor të saj;

**Rregullator** nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Mbeturina. Gjithashtu referohet si “Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (“ZRRUM”) e krijuar nën Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë apo organizatën e saj pasardhëse;

**Rrjeti i Ujit** nënkupton të gjitha asetet e shfrytëzuara për dhe/ose në lidhje me ofrimin dhe/ose marrjen e Shërbimeve të Ujit qoftë atyre që i përkasin domenit publik ose Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

**Shërbimet e Ujërave të Zeza** nënkupton mbledhjen, zbrazjen dhe përpunimin e ujërave të zeza dhe kanalizimit;

**Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza** nënkupton ofrimin e shërbimeve publike të marrjes, përpunimit, transportimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum njerëzor dhe të shërbimeve publike që përbëhen nga operimet e rrjeteve publike të mbledhjes dhe zbrazjes së ujërave të zeza dhe kanalizimit;

**Shërbimet e Ujit** nënkupton marrjen (kaptimin), përpunimin, dhe shpërndarjen e ujit për konsum njerëzor dhe operimin e rrjetit dhe të objekteve për atë qëllim; dhe

**Shpenzimet e Lidhura me Vëllimin** gjithashtu të njohura edhe si "Kosto Variabile" nënkupton koston e cila ndryshon sipas nivelit të produktit, për shembull energjia dhe kemikalet.

**Shpenzimet Fikse Operative**, gjithashtu të njohura si "Kosto Fikse" nënkupton kostot të cilat nuk ndryshojnë me nivelin e të dalave, për shembull Amortizimi, mirëmbajtja e llogarive të konsumatorit dhe ofrimi i infrastrukturës të përbashkët për të gjithë konsumatorët;

**Shpenzimet Operative** (shkurtesa "SHPEOP") nënkupton shpenzimet qarkulluese ditore, siç janë shpenzimet për mbështetje administrative, pagat, karburantet, kemikaljet, meditet, transporti, energjia, pjesët rezervë dhe shpenzimet për mirëmbajtje të rregulltë të nevojshme për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e objekteve në mënyrë që të arrihet kapaciteti dhe përmbushja e detyrave për të cilat është caktuar dhe ndërtuar dhe të cilat janë të llogaritura gjatë afatit prej një viti ose më pak;

**Sistemi i Mbledhjes së Ujërave të Zeza** nënkupton të gjitha asetet e shfrytëzuara për dhe/ose në lidhje me ofrimin dhe/ose marrjen e Shërbimeve për Ujëra të Zeza qoftë atyre që i përkasin domenit publik ose të Ofruesve të Shërbimeve për Ujë dhe Ujërave të Zeza;

**Shpenzimet Administrative** nënkuptojnë shpenzimet për menaxhment dhe përkrahëse lidhur me ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Shërbimet e Ujit me Shumicë;

**Shpenzimet Kapitale** (shkurtesa "SHPEKA") nënkupton shpenzimet e shkaktuara në lidhje me investimet në asetet fikse me jetëzgjatje më shumë se një vit, duke përfshirë, pa kufizime shpenzimet të cilat janë të llogaritura për t'u amortizuar dhe zhvlerësuar gjatë jetëzgjatjes së cilitdo aset fiks të dhënë, të klasifikuar si pronë, fabrikë ose paisje;

**Tarifa e Ujit me Shumicë** nënkupton cilitdo vlera, ngarkesa apo taksa të Furnizuesit të Ujit me Shumicë në lidhje me furnizimin me Ujë me Shumicë tek Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza;

**Tarifa e Shërbimit** nënkupton cilatdo vlera, ngarkesa apo taksa të Ofruesit të Shërbimeve në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të tij tek Konsumatorët;

**Të Hyrat e Nevojshme nga Operimet** nënkupton të hollat e nevojshme për të mbuluar shpenzimet për të ofruar Shërbime për Ujë dhe Ujëra të Zeza ose të Furnizimit të Ujit me Shumicë të llogaritura sipas dispozitave të kapitullit 6 të Pjesës III të kësaj Rregulle;

**Të Hyrat nga Operimet** nënkupton të hollat e pranuar nga ofrimi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, p.sh. shitja e ujit. Nuk përfshinë kamatën e fituar ose fitimet dhe humbjet nga disponimi i pronës;

**Urdhëresa e Tarifave të Shërbimit** nënkupton dokumentin me shkrim të lëshuar nga Rregullatori që rradhinë të gjitha Tarifat e Shërbimeve që duhet të aplikohen në Zonën e Shërbimeve sipas llojit të shërbimit, vendndodhjes dhe kategorisë së Konsumatorit dhe ngarkesat për Shërbimet të Ujit dhe Ujërave të Zeza të ofruara tek Konsumatorët;

**Vlera e Mbetur**, gjithashtu e njohur edhe si "Vlera e Shpëtuar", nënkupton vlerën e asetit fiks në fund të Jetëzgjatjes së Dobishme;

**Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina**, gjithashtu e shkurtuar në "ZRRUM", nënkupton Rregullatorin Ekonomik të krijuar me ligjin e aplikueshëm;

#### Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë definuar në mënyrë të posaqme dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të kenë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Hyrjen e kësaj Rregulle dhe/ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull do të interpretohen sipas kuptimit të cilitdo Rregull të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me pushtetin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas;
- (d) Fjalët që përdoren në cilëndo gjini do të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse shprehimisht nuk është thënë ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të këtyre Rregullave

#### Neni 6: Përfshirja

Nga të gjitha Ndërmarrjet Publike në Kosovë që aktualisht ofrojnë Shërbimet të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose Furnizimin e Ujit me Shumicë kërkohet të dorëzojnë për aprovim te Rregullatori çmimet e ujit dhe ujërave të zeza për përdorime të ndryshme sipas strukturës së tyre terifore të llogaritura sipas kësaj Rregulle përveç nëse nuk bëhet përjashtim i veçantë dhe i dhënë me shkrim nga Rregullatori.

## **PJESA II: PARIMET E PËRGJITHSHME PËR VËNIEN E TARIFAVE**

### **Kapituli 2: Parimet e Përgjithshme**

#### **Neni 7: Parimet e Përgjithshme për Tarifat e Shërbimeve**

- 7.1. Jo-Diskriminimi: Ofruesi i Shërbimeve nuk duhet të sillet në asnjë mënyrë diskriminuese ndaj asnjë Personi në çfarido baze lidhur me tarifat të cilat i ngarkon.
- 7.2. Ekulibrimi: Tarifat janë të balancuara në standardeve minimale të shërbimeve, realizueshmërinë financiare të Ofruesit të Shërbimeve dhe mundësisë së Konsumatorëve për të paguar.
- 7.3. Mbulimi i Kostos: Tarifat duhet të gjenerojnë mjete financiare të nevojshme për ofruesin e shërbimeve, që me kusht të operimit në kondita efikase, të mbulojë shpenzimet e veta operative dhe të mirëmbajtjes, kostot e arsyeshme të paplanifikuara, dhe poashtu të gjenerojë tepricën e nevojshme për financimin e shpenzimeve kapitale.
- 7.4. Shfrytëzuesi Pagan (Barazia e Konsumatorëve): Çdo konsumator do të ngarkohet për koston e plotë për furnizim. Konsumatorët paguajnë në tërësi dhe në kohë të caktuar. Dështimi për të paguar rezulton në gjorbitjet financiare dhe së fundi shkyçjen e shërbimit për ujë sipas Rregullës së ZRRUM mbi Shkyçjen e Shërbimeve për Ujë.
- 7.5. Barazia Sociale: Struktura e tarifave do të pasqyrojë barazinë dhe drejtësinë e shërbimeve dhe të çmimeve. Qeveria e Kosovës mund të subvencinoj shfrytëzuesit me të ardhura të ulta përmes pagesave të drejtpërdrejta tek Ofruesit e Shërbimeve në emër të shfrytëzuesve të caktuar për shërbimet e ofruara.
- 7.6. Kursimi i Resurseve: Struktura e Tarifave do të caktojë çmime më të larta variabile për nivelet më të larta të konsumimit me qëllim të inkurajimit të kursimit.
- 7.7. Harmonizimi brenda Zonës së Shërbimit: Për shërbimet që iu ofrohen shfrytëzuesve shtëpiak në një zonë me popullësi që nuk tejkalon pesëqind (500) banorë, tarifat do të harmonizohen me ato që aplikohen në zonat më të populluara në Zonën e njëjtë të Shërbimit.
- 7.8. Performanca e Ofruesit të Shërbimit: Ofruesi i Shërbimit nuk do të kompenzohet përmes tarifave për kryerjen joefikase dhe joefektive të detyrave të veta.

#### **Neni 8: Zbatueshmëria e Tarifave të Shërbimit brenda Zonës së Shërbimit**

- 8.1. Përveç kur ndryshe autorizohet nga Rregullatori, Ofruesit e Shërbimeve duhet të përdorin Tarifat e Njejtë të Shërbimeve përgjatë tërë Zonës së Shërbimit.
- 8.2. Ofruesi i Shërbimeve mundet të kërkojë me shkrim nga Rregullatori autorizimin për të përdorur Tarifat tjera të Shërbimit që dallojnë nga ato të Zonës së Shërbimit duke

shpejguar dhe arsyetuar shkaqet për të vepruar në këtë mënyrë dhe Rregullatori duhet të përgjigjet me shkrim brenda njëzet (20) Ditëve të Punës nga data e pranimit të asaj kërkesë, duke u pajtuar ose refuzuar për të vepruar dhe duke dhënë arsyet.

#### Neni 9: Kategoritë e Konsumatorëve Për Rregullimine Tarifave për Shërbime

- 9.1. Tarifat e Shërbimit për Shërbimet e Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të përfshijnë jo më shumë se tri kategori të Konsumatorëve:
  - (a) Shtëpiak;
  - (b) Komercial/Industrial; dhe
  - (c) Institucional.
- 9.2. Konsumatorët e Ujit me Shumicë duhet të jenë e vetmja Kategori e Konsumatorëve për Furnizimin e Ujit me Shumicë.

### **Kapitulli 3: Metodatat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit**

#### Neni 10: Metodatat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit

- 10.1. Përderisa Ofruesi i Shërbimeve është në pozitë të shfrytëzojë metodën e Kostos Margjinale Afat-Gjatë (KMAGJ), mund të përdoret metoda e Mbulimit të Kostos për të përcaktuar Tarifat e tyre të Shërbimeve për ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ose Furnizimin e Ujit me Shumicë.
- 10.2. Metoda e Mbulimit të Kostos vlerëson kërkesat e të hollave të gatshme që i nevojiten Ofruesit të Shërbimeve për të mbuluar shpenzimet e tij vjetore.
- 10.3. Nëse ndonjë Ofrues i Shërbimeve do të preferojë të përdorë ndonjë metodë tjetër për të llogaritur Tarifatat e Shërbimit, ose të modifikojë cilatdo procedura të specifikuar në këtë Rregull, duhet t'i shkruajë një shkresë Rregullatorit duke shpjeguar kërkesën e tij dhe Rregullatori do të përgjigjet me shkrim brenda njëzet (20) Ditëve të Punës nga data e pranimit të komunikatës së latëpërmendur, duke u pajtuar ose refuzuar veprimin për të bërë një gjë të tillë ofruar arsyet për këtë.
- 10.4. Rregullatori mund të refuzojë metodën e Mbulimit të Kostos ose cilëndo metodë tjetër dhe të kërkojë përdorimin e metodës KMAGJ sa më parë që të jetë praktike.

### **Kapitulli 4: Vendosja e Tarifave të Shërbimit**

#### Neni 11: Vendosja e Tarifave të Shërbimit

Tarifatat e Shërbimit mund të caktohen qoftë:

- (a) Nga Rregullatori përmes shqyrtimit dhe aprovimit të Aplikacionit për Tarifa të Shërbimit të dorëzuar nga Ofruesi i Shërbimeve sipas Nenit 29; ose

- (b) Përmes Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit në mes të Rregullatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas dispozitave të PJESËS VII së kësaj Rregulle.

### **PJESA III: LLOGARTIJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT SIPAS METODËS PËR RIGJENERIMIN E KOSTOS PËR SHËRBIMET PËR UJË**

#### **Kapitulli 5: Hapat për Llogaritjen e Tarifave për Shërbime**

##### Neni 12: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit të Ujit

Tarifat e Shërbimit do të llogariten përmes hapave vijues:

- (a) Hapi 1: Vlerësimi i Kostos Totale të Ofrimit të Shërbimeve të përcaktuar si në Kapitullin 6;
- (b) Hapi 2: Vlerësimi i të Hyrave të Kërkuara nga Operimet të përcaktuar si në Kapitullin 7;
- (c) Hapi 3: Vlerësimi i vëllimit të ujit që do shitet siq është përcaktuar në Kapitullin 8;
- (d) Hapi 4: Llogaritja e çmimit për metër kub të ujit të shitur e përcaktuar si në Kapitullin 8; dhe
- (e) Hapi 5: Konfirmimi që të Hyrat të Kërkuara nga Operimet janë të mjaftueshme për të paguar Kostot totale të vlerësuara për të Ofruar Shërbimet.

#### **Kapitulli 6: Llogaritja e Kostos në Ofrimin e Shërbimeve**

##### Neni 13: Llogaritja e Kostos të Shërbimeve të Ofruara

- 13.1. Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza duhet të përdorin të dhënat e kostove historike të marrura nga shënimet e kontabilitetit të organizuara dhe të mirëmbajtura sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës dhe nga ofertat për furnizime të ngjashme, shërbime dhe punë, për të vlerësuar:

Shpenzimet Operative vjetore;

Shlyerja e Borxhit;

Llogaritë e painkasuara vjetore;

Shpenzimet Kapitale për financimin e projekteve të cilët:

mirëmbajnë ose përmirësojnë kualitetin, besueshmërinë, ose sigurinë e shërbimit; zëvendësojnë asetet fikse të jetëzgjatja të cilave (afati i përdorimit ose afati ekonomik) ka përfunduar;

çojnë në rehabilitime të mëdha dhe/ose punë të jashtzakonshme të mirëmbajtjes në asetet fikse që kanë të bëjnë me Rrjetin e Ujit ose të Sistemit të Mbledhjes së Ujërave të Zeza

zvogëlojnë Shpenzimet Operative;

zgjerojnë shërbimet në Zonën e Shërbimeve dhe rrisin numrin e Konsumatorëve.

- 13.2. Kostot Totale për Ofrimin e Shërbimeve të radhitura në nën-nenin 13.1 do të llogariten sipas dispozitave të neneve në vazhdimt këtij Kapitulli.

#### Neni 14: Llogaritja e Shpenzimeve Operative

- 14.1 Shpenzimet Operative të lejuara për qëllime të llogaritjes së Tarifave të Shërbimit do të përfshijnë, pa kufizime, kostot që kanë të bëjnë me:

pagat dhe kontributet për sigurimin social dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me listat e rrogave;

obligimet e qirasë për cilatdo prona apo asete të marra me qira;

blerja e ujit;

energja elektrike;

kemikalet;

materialet;

riparimet dhe mirëmbajtja;

karburantet;

pagesat ndaj Rregullatorit; dhe

kostot tjera të aplikueshme për ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe për furnizimin për Ujë me Shumicë të cilat kërkohen sipas shtojcave të kësaj Rregulle ose të cilat kohë pas kohe mund të konsiderohen nga Rregullatori si Shpenzime Operative të shkaktuara në mënyrë të arsyeshme.

- 14.2. Shpenzimet Operative do të bazohen në të dhënat e kostove historike që mirren nga Sistemi i Kontabilitetit të Kostove Rrjedhëse të bëra sipas Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës dhe ofertat për furnizime të ngjajshme, shërbime dhe punë. Kur një sistem i tillë i kontabilitetit nuk është akoma i vendosur, kostot do të vlerësohen nga librat e kontabilitetit ekzistues ose nga të dhënat regjionale.

- 14.3 Shpenzimet Operative Fikse do të llogariten duke u bazuar në kostot aktuale të komponenteve të shërbimeve individuale dhe si përqindje e aseteve bruto.
- 14.4 Shpenzimet e Lidhura me Vëllimin do të llogariten nga kostot aktuale të energjisë, kemikaljeve, inventarit, personelit, transportit, etj, të përdorura në ofrimin dhe dërgimin e ujit të pijshëm tel konsumatorët dhe duke larguar dhe përpunuar ujërat e zeza në standardet e pranueshme.

#### Neni 15: Kostot e Përrjashtuara nga Njehsimi i Shpenzimeve Operative

- 15.1. Shpenzimet Operative nuk do të përfshijnë asnjë parashikim për inflacion të çmimeve për vitet e Tarifave të Shërbimit në konsiderim, por do të mirren me inflacionin sipas Kapitullit 15.
- 15.2. Me qëllim të përcaktimit të Tarifave, shpenzimet e amortizimit nuk do të përfshihen në Shpenzimet Operative.
- 15.3. Të gjitha kostot e llogaritura do të përjashtojnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar që mund të jetë i aplikueshëm në Kosovë përveç se kur cilado shumë e tatimeve të tilla në mënyrë të ligjshme nuk zbritet nga shumat e atyre tatimeve për të cilat kërkohet nga Ofruesi i Shërbimeve të paguajë kohë pas kohe tek autoritetet përkatëse të administratës tatimore.
- 15.4. Të gjitha llogaritjet e kostove do të përjashtojnë të gjithat tatimet tjera indirekte të cilat në mënyrë të ligjshme mund të u ringarkohen Konsumatorëve ose që janë të zbritshme në mënyrë të ligjshme prej shumave të tatimeve të cilat kërkohet nga Ofruesi i Shërbimeve të paguajë te autoritetet përkatëse të administratës tatimore kohë pas kohe.
- 15.5. Gjjobat e caktuara dhe të pagueshme nga Ofruesi i Shërbimeve për shkak të shkeljes së ligjeve apo rregulloreve ose rregullave ose urdhërave të lëshuara nga Rregullatori ose ndonjë autoritet tjetër publik në Kosovë nuk do të përfshihen si Shpenzime Operative.
- 15.6. Rregullatori gjithashtu kohë pas kohe mund të përcaktojë kostot që nuk janë të pranueshme për qëllime të llogaritjes së tatimeve mbi fitimin dhe/apo tatimet tjera mbi të ardhurat sipas ligjeve tatimore që janë në fuqi në Kosovë për t'u përjashtuar nga llogaritja e Shpenzimeve Operative.

#### Neni 16: Kostot e Shërbimeve të Borxhit

Kur të jetë e realizueshme, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përfshijë kostot e financimit dhe shpenzimet tjera financiare për shërbime të borxhit.

#### Neni 17: Pranimi i Kontove të Pa-Inkasuara

- 17.1. Për qëllime të përcaktimit të Tarifave të Shërbimit për cilindo vit të dhënë, Ofruesi i

Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të merr parasysh një vlerë që është ekuivalente me një përqindje të caktuar të bilancit të Llogarive të Pa-Inkasuara në fund vitit fiskal praparak prej atij për të cilin përcaktohen Tarifat e Shërbimit.

- 17.2. Brenda bilancit Llogarive të Pranueshme kjo përqindje do të aplikohet vetëm në ato pika që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me dërgimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza për të cilat është i licensuar Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza\
- 17.3. Shuma e përqindjes që do të lejohet do të propozohet nga Ofruesi i Shërbimeve në Aplikimin për tarifa të Shërbimit dhe do të aprovohet nga Rregullatori.ss

#### Neni 18: Shpenzimet Kapitale

- 18.1 Secili Ofrues i Shërbimeve do të përgatitë Planin e Menaxhimit të Aseteve sipas formatit në Shtojcën e kësaj Rregulle.
- 18.2 Plani i Menaxhimit të Aseteve do të rradhite projektet kapitale që kanë për qëllim zvogëlimin e kostove, mirëmbajtjen e stabilimenteve dhe paisjeve, përmirësimin e shërbimit dhe zgjerimin e shërbimit.
- 18.3 Plani Menaxhues i Pronësive do të jetë për periudhën dhjetë vjeçare dhe do të freskohet me informata çdo vit.
- 18.4 Shpenzimet kapitale për kalkulimin e Tarifave të Shërbimit do të jenë shuma e kostove të vlerësuara për projektet kapitale të rradhitura në Planin e Menaxhimit të Aseteve për vitin përkatës.
- 18.5 Asnjë Shpenzim Kapital i paguar nga donacionet e donatorëve nuk do të përfshihet në llogaritjen e Tarifave të Shërbimit por mund të përdoret si informatë referuese për kostot.

#### Neni 19: Përmbledhja e Kostove

Secili Ofrues i Shërbimeve do të përmbledhë kostot e përdorura në Kalkulimin e Tarifave të Shërbimit sipas formatit në shtojcën e kësaj Rregulle.

### **Kapitulli 7: Vlerësimi i të Hyrave të Kërkuara nga Operimet**

#### Neni 20: Vlerësimi i të Hyrave të Kërkuara nga Operimet

Ofruesit Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të përcaktojnë të Hyrat e kërkuara nga Operimet duke shtuar Shpenzimet Operative plus kostot për shërbime të borxhit plus medijtjet për Llogaritë e Pranueshme të Pa-grumbullueshme plus Shpenzimet Kapitale.

## **Kapitulli 8: Llogaritja e Kostove të Ujit që duhet Shitur**

### Neni 21: Llogaritja e Kostove të Ujit që Duhet Shitur

- 21.1 Në hapin e tretë të Llogaritjes së Tarifave të Shërbimit, Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të vlerësojë vëllimin e ujit që duhet shitur në bazë të:
- 27.3 të dhënave historike për konsumimin e ujit të regjistruar në vitet e mëparshme;
  - 27.4 parashikimit të zvhillimit të konsumit të ujit për Konsumator në bazë të studimeve dhe analizave që janë në dispozicion.
- 21.2 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujëra të Zeza do të vlerësojnë vëllimin total të ujit që duhet shitur për secilën Kategori të Konsumatorëve të rradhitura në nën-nenin 9.1

### Neni 22: Llogaritja e Kostos për Metër Kub të Ujit të Shitur

Në hapin e katërt të Llogaritjes së Tarifave të Shërbimit, Ofruesi i Shërbimeve do të llogarisë koston për metër kub të ujit duke e pjestuar të Hyrat e Kërkuara nga Operimet të përcaktuara në Nenin 20, me vëllimin e vlerësuar të ujit që duhet të shitet.

## **Kapitulli 9: Llogaritja e Të Hyrave të Vlerësuara nga Operimet**

### Neni 23: Llogaritja e Të Hyrave të Vlerësuara nga Operimet

- 23.1 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të llogarisin të Hyrat e vlerësuara nga Operimet për secilën Kategori të Konsumatorëve në bazë të vëllimit të vlerësuar të ujit të shitur nga Neni 21 dhe në bazë të koston për metër kub të ujit nga Neni 22.
- 23.2 Furnizuesi i Ujit me Shumicë do të bëjë llogaritje të ngjajshme me ato të përcaktuara në nën-nenin 23.1 për një kategori të vetme të Konsumatorit me Shumicë.

### Neni 24: Analizat e Ndjeshmërisë për të Hyrat e Vlerësuara nga Operimet

Ofruesit e Shërbimeve do të bëjnë Analizat e Ndjeshmërisë të llogaritjes së të hyrave të vlerësuara dhe do t'ia bashkangjesin atë Aplikacionit të tyre për Tarifa të Shërbimit.

## **Kapitulli 10: Llogaritja dhe Struktura e Tarifave të Shërbimit që i Propozohet Rregullatorit**

### Neni 25: Llogaritja e dhe Struktura e Tarifave në Shërbime që i Propozohet Rregullatorit

- 25.1 Në hapin e pestë Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza do të konfirmojnë se të Hyra e Kërkuara nga Operimet që priten nga Tarifat totale të Shërbimeve që do t'i propozohen Rregullatorit do të jenë më të mëdha ose të barabarta me shumën e Shpenzimeve totale në para të gatshme të llogaritura sipas Nenit 14, Nenit 16, Nenit 17

dhe Nenit 18.

- 25.2 Ofruesit e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza në Aplikacionin e tyre për Tarifa të Shërbime do t'ia paraqesin Rregullatorit propozimin për Tarifa të Shërbimit me të cilat do të ngarkohen secila Kategori e Konsumatorëve siç është e definuar në Nenin 26 të poshtëshënuar.

#### Neni 26: Shuma për Faturimine Konsumatorët

- 26.1 Shuma për Faturimin e Konsumatorëve do të përbëhet prej dy ngarkesave:

Ngarkesa për mbulimin e shpenzimeve që kanë të bëjnë me Konsumatorin për: leximin e ujmëmatësave, faturimin dhe inkasimin.

Ngarkesa për vëllimin e ujit të shfrytëzuar nga Konsumatori.

- 26.2 Ngarkesa e Shërbimit në nën-nenin 26.1(a) me lartë do të:

Faturohet edhe nëse Konsumatori nuk ka shfrytëzuar ujin në periudhën të cilës i referohet Fatura;

Bazohet në kostot aktuale kur janë në dispozicion por në cilindo rast nuk do të jetë më e vogël se dy (2) euro gjatë vitit të parë pas vitit kur kjo rregull ka hyrë në fuqi;

Në vitet vijuese do të bazohet në kostot aktuale ashtu siç janë të regjistruara nga Ofruesi i Shërbimeve në librat e tij të kontabilitetit të revizionuar.

- 26.3 Ngarkesa e Vëllimit në nën-nenin 26.1 do të llogaritet duke shumëzuar vëllimin e ujit të shpenzuar me koston për metër kub të shumëzuar me faktorët në shtojcën e kësaj Rregulle të cilat janë të bazuara në vëllimin e konsumit dhe kategorit e Konsumatorëve.

Vëllimi i ngarkuar = Vëllimi i shfrytëzuar x Euro/m<sup>3</sup> x Faktori  
(ku Faktori është funksion i kategorisë së konsumatorit dhe Bllokut të Sasisë)

### **PJESA IV:LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT ME METODËN E MBULIMIT TË KOSTOS PËR SHËRBIMET E UJRAVE TË ZEZA**

#### **Kapitulli 11: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit të Ujërave të Zeza**

##### Neni 27: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit të Ujërave të Zeza

- 27.1 Kostot që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve të Ujërave të Zeza nuk do të llogariten ndaras por do tu shtohen kostove që kanë të bëjnë me ofrimin Shërbimeve të Ujit, të llogaritura në pajtim me rregullat e paraqitura më lartë në Pjesën III të kësaj

Rregulle.

- 27.2 Alokimi i pjesës nga kostot totale të krijuara në lidhje me ofrimin e të dy Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza e posaçërisht në ofrimin e Shërbimeve të Ujërave të Zeza do të bëhen në bazë të vëllimit të ujërave të zeza të mbledhura për secilin Konsumator.
- 28.3 Vëllimi i Ujërave të zeza të për çdo Konsumator do të jetë i barabartë me vëllimin e ujit të pijshëm i lexuar në ujëmatësin e Konsumatorit.
- 28.4 Për shkarkimin e Ujërave Industriale do të shtohet një taksë e mbi-ngarkesës për ujëra të zeza e bazuar në vëllimin dhe ngarkesën e matur me parametrat e Nevojës së Oksigjenit Biokimik (NOB) dhe Nevojës së Oksigjenit Kimik (NOK) dhe Materialet e Suspenduara (MS) që tejkalojnë sasitë e përcaktuara në Shtojcën e kësaj Rregulle.
- 27.5 Faturimi i Konsumatorëve për ujërat të zeza do të bëhet duke u bazuar në kategorit e ndryshme të Konsumatorëve të rradhitur në nën-nenin 9.1.
- 27.1 Konsumatorët do të ngarkohen për ofrimin e Shërbimeve të Ujërave të Zeza vetëm në vëllimit të ujërave të zeza të mbledhura dhe për mbi-ngarkesat për shkarkimin e Ujërave Industriale, kur është e aplikueshme, dhe nuk do të ngarkohet asnjë taksë fikse për kyçjen e tyre në Sistemin për Mbledhjen e Ujërave të Zeza.

## **PJESA V: LLOGARITJA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT ME METODËN E MBULIMIT TE KOSTOS PËR UJIN ME SHUMICË**

### **Kalpitulli 12: Hapat për Llogaritjen e Tarifave të Shërbimit për Ujin me Shumicë**

#### **Neni 28: Llogaritja e Tarifave për Ujin me Shumicë**

- 28.1 Tarifa e Ujit me Shumicë do të llogaritet duke aplikuar rregullat e njëjta të paraqitura në Pjesën III më lartë për llogaritjen e Tarifave të Shërbimit për Ujë dhe Ujëra të Zeza me adaptime të nevojshme.
- 28.2 Tarifa e Ujit me Shumicë do të përfshijë Kthimin në Asetet Fikse për Furnizuesin e Ujit me Shumicë që është e përcaktuar në shtojcën e kësaj Rregulle dhe do të ndryshohet kohë pas kohe.
- 28.3 Llogaritja e Tarifave për Shërbime do të përfshijë vetëm ato Asete Fikse të përdorura për mbledhjen, depozitimin dhe bartjen e Ujit me Shumicë tek Ofruesi i Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza.
- 28.4 Asetet Fikse do të vlerësohen me koston totale të fitimit historik minus amortizimi i akumuluar.
- 28.5 Kur këto Asete Fikse shërbejnë për përdorime të shumëfishta (psh penda e cila e

akumulon ujin e shfrytëzuar për bujqësi, për hidro energjinë, për konsumatorët industrial dhe për ofruesin e shërbimit të ujit), atëherë vlera e Asetit Fiks të përdorur në llogaritjen e tarifës do të jetë në përpjesëtim me përqindjen e ujit total të shfrytëzuar si furnizim i ujit me shumicë.

- 28.6 Furnizuesit e Ujit me Shumicë në Aplikacionin e tyre për Tarifa të Shërbimeve do të propozojnë Vlerën Kthyese në Asete për t'u aprovuar nga Rregullatori.
- 28.7 Furnizuesit e Ujit me Shumicë nuk do të kenë lehtësime për Kontot a Painkasuara.
- 28.8 Fatura për Ujin me Shumicë do të llogaritet në bazë të:
- 28.7 Kosos për metër kub të Ujit me Shumicë të furnizuar; dhe
- 28.8 Shumës së barabartë me Vlerën Kthyese në Asete e llogaritur në pajtim me dispozitat e këtij Neni gjithashtu të llogaritura për metër kub të Ujit me Shumicë të shitur.
- 28.9 Faturat për Konsumatorët e furnizuar me Ujë me Shumicë do të përfshijnë çmimin për metër kub të Ujit me Shumicë të shitur pa diskriminim të dy komponentat për llogaritjen e atij çmimi të konsideruar në pajtim me nën-nenin 28.8 më lartë, dhe nuk do të përfshijnë asnjë ngarkesë për kyçje të Konsumatorëve në Rrjetin e Ujit.

## **PJESA VI: SHOYRTIMI DHE APROVIMI I APLIKACIONEVE TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 13: Aplikimi, Shqyrtimi dhe Aprovimi i Tarifave të Shërbimit**

#### **Neni 29: Aplikacioni për Tarifa të Shërbimit**

- 29.2. Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit me bashkangjitjet duke përdorur formatin e dhënë në shtojcën e kësaj Rregulle ose ose ndonjë format tjetër që caktohet nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 29.2. Aplikacioni për Tarifa të Shërbimit duhet të aprovohet nga Bordi Mbikqyrës i Ofruesit të Shërbimeve që dëshmohet me letrën e përcjelljes të nënshkruar nga autoriteti relevant
- 29.3. Në mungesë të Aplikacionit për Tarifa të Shërbimit, ose në rast të dështimit për të ofruar të dhënat e kërkuara, atëherë Rregullatori do të përcaktojë Tarifat e Shërbimit të bazuara në kostot e supozuara dhe në bazë të nivelit të përmbushjes në ofrimin e Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza ngajshëm me Ofruesit tjerë të Shërbimeve në Kosovë.

#### **Neni 30: Shqyrtimi nga Rregullatori i Aplikacioneve për Tarifa të Shërbimit**

- 30.1. Rregullatori do të konfirmojë që Aplikacioni është në pajtim me dispozitat e kësaj

Rregulle, të vlerësojë Aplikacionin për Shërbime dhe të përgjigjet në pajtim me afatet në shtojcën ekësaj Rregulle.

30.2. Rregullatori do të vlerësojë Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit sipas në hapave vijues:

28.9 Të verifikojë se Tarifat e Shërbimit të propozuara janë në pajtim me Parimet e Përgjithshme të rradhitura në Nenin 7;

29.3. Të verifikojë se Tarifat e Shërbimit të propozuara janë llogaritur sipas kërkesave të kësaj Rregulle;

30.1. Të konstatojë se a janë plotësuar apo janë afër për tu plotësuar standardet financiare dhe teknike në kuadër të afateve të përcaktuara ose të dakorduara nga Rregullatori për arritjen e Standardeve Minimale dhe Treguesve Kyq të Punës të përcaktuar në këtë Rregull të nxjerrë, ndryshuar dhe/ose të plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe.

30.3. Në vlerësimin e kërkesës për vendosjen e Tarifave të Shërbimit të dorëzuar nga Ofruesit e Shërbimeve, Rregullatori gjithashtu mund të merr parasysh edhe rezultatet financiare dhe ekonomike të tyre duke i krahasuar me rezultatet e Ofruesve tjerë të Shërbimeve në dhe/ose jashtë Kosovës kur madhësia, shkalla e zhvillimit, resurset, numri i Konsumatorëve dhe cilëtdo parametra tjerë i bëjnë të krahasueshme rezultatet e tyre me ato aplikuesit për tarifa të Shërbimit.

#### Neni 31: Aprovimi i Tarifave të Shërbimit

31.1. Në bazë të kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në këtë Nen, me apo pa modifikime, Rregullatori do të aprovojë me shkrim Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit duke lëshuar Urdhëresën e Tarifave.

31.2. Tarifat e Shërbimit të aprovuara do të mbesin të pandryshuara për një vit, megjithate korrigjimet (përshtatjet) në Tarifa për Shërbime do të mirren parasysh në rasta të jashtëzakonshme kur:

(a) Vjen deri te rrethanat e veçanta ekonomike; ose

(b) Ofruesi i Shërbimeve kërkon korrigjimin (përshtatjen) sipas Nenit 33.

#### **Kapitulli 14: Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit**

##### Neni 32: Kohëzgjatja e Tarifave të Shërbimit

32.1. Rregullatori do të aprovojë Tarifat e Shërbimit për një periudhë minimale prej një (1) viti kalendarik dhe për periudhën maksimale për pesë (5) vite kalendarike.

32.2. Rregullatori do të njoftojë me shkrim të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për obligimet e

tyre për të dorëzuar Aplikacionin për Tarifa të Shërbimit duke treguar kohëzgjatjen e Tarifave të Shërbimit ashtu siq përcaktohet.

- 32.3. Tarifat për Shërbime që do të vendosen për periudhën e parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle do të caktohen për një (1) vit kalendarik.

## **PJESA VII: KORRIGJIMET DHE RISHIKIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT**

### **Kapitulli 15: Korrigjimet e Tarifave të Shërbimit**

#### **Neni 33: Kërkesa për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit**

- 33.1. Në rast të rrethanave të jashtzakonshme të cilat nuk kanë mund të parashihen në kohën e dorëzimit të Aplikacionit për Tarifa të Shërbimit, Ofruesit e Shërbimeve në çfarëdo kohe mund të dorëzojnë tek Rregullatori kërkesën me shkrim për të korrigjuar Tarifat e Shërbimit para përfundimit të periudhës për të cilën janë caktuar Tarifat e Shërbimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në shtojcën e kësaj Rregulle.
- 33.2. Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë të dhënat teknike dhe financiare të cilat përmbledhin rezultatet e punës, duke përfshirë edhe nivelin e përmirëimit të rezultateve të punës të përcaktuar në marrëveshje me Rregullatorin gjatë periudhës që përfshihet me Tarifat e Shërbimit në fuqi, dhe të cilat ofrojnë justifikimin për korrigjimin e kërkuar të Tarifave të Shërbimit, në përputhje me ecurinë e aprovuar, ndryshuar ode plotësuar nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 33.3. Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë të përmbledhur strukturën e propozuar të tarifave të korrigjuara në formën e përcaktuar nga Rregullatori në shtojcën e kësaj Rregulle.
- 33.4. Ofruesi i Shërbimeve do të ofrojë arsyetimin e qartë për korrigjimin e propozuar të Tarifave të Shërbimit.

#### **Neni 34: Procedurat për Aprovimin e Korrigjimit të Tarifave të Shërbimit**

- 34.1. Rregullatori do të konfirmojë se Kërkesa për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit i është në përputhje me Rregullën e Tarifave të Shërbimit dhe e vlerëson dhe përgjigjet në të brenda dyzet e pesë (45) Ditë Pune nga data kur Rregullatori ka pranuar atë kërkesë.
- 34.2. Rregullatori do të vlerësojë Kërkesën për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit sipas hapave vijues:
- 31.1. Të verifikojë që parametrat, kushtet dhe rrethanat që justifikojnë Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit janë plotësuar;
- 31.2. Të verifikojë që si rezultat i korrigjimit të propozuar, Tarifat e Shërbimit janë në

pajtim me Parimet e Përgjithshme të rradhitura në Nenin 7;

(c) Të verifikojë se korrigjimi i propozuar i Tarifave të Shërbimit është llogaritur sipas kërkesave të kësaj Rregulle;

33.1. Të konstatojë nëse niveli i përcaktuar i përmirësimit të rezultateve të punës, duke përfshi pa kufizime, rezultatet e punës që kanë të bëjnë me Standardet e Shërbimit janë plotësuar ose kanë gjasa për tu plotësuar në afatin e përcaktuar ose të dakorduar nga ana e Rregullatorit kohë pas kohe.

34.3. Nëse Kërkesa për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit dështon të plotësojë këto kritere të vlerësimit, ajo do të kthehet Ofruesit të Shërbimeve me arsyetimet pse nuk është aprovuar.

34.4. Nëse plotësohen kriteret e vlerësimit Rregullatori do të aprovojë me shkrim Kërkesën për Korrigjimin e Tarifave të Shërbimit duke lëshuar Urdhërin për Tarifa të Shërbimit.

#### Neni 35: Refuzimi i Korrigjimit të Tarifave të Shërbimit

Rregullatori mund të refuzojë të aprovojë kërkesën për korrigjimin e Tarifave të Shërbimit duke u bazuar në:

33.2. dështimin e Aplikuesit për të ofruar informacionet e kërkuara brenda afatit kohor të përcaktuar;

33.3. vlerësimin që kërkesa e Aplikuesit është në shpërputhje me shërbimet e ofruara;

33.4. përcaktimin se Aplikuesi ka dështuar të arrijë standardet minimale të shërbimit;

34.1. dështimin e Aplikuesit për të kontrolluar kostot operative ose humbjet e ujit apo të dyjat.

### **Kapituli 16: Rishikimi i Tarifave të Shërbimit**

#### Neni 36 Shqyrtimi i Tarifave për Shërbime

36.1. Kur Tarifat e Shërbimit janë të caktuara për periudhë me kohëzgjatje që tejkalon një (1) vit kalendarik, Rregullatori në Urdhërin e Tarifave të Shërbimit me të cilin aprovohen Tarifat e Shërbimit, do të bëjë të qarta kriteret dhe procedurat të cilat duhet ndjekur për rishikimin vjetor të Tarifave të Shërbimit.

37.2. Kriteri që duhet ndjekur nga Rregullatorit për shqyrtimin e Tarifave të Shërbimit të aprovuara për periudhën që tejkalon një (1) vit kalendarik, do të përfshijnë pa kufizime, si në vijon:

Ndikimet e inflacionit në vitin e parë të aplikimit të Tarifave të aprovuara të

Shërbimit duke shfrytëzuar indeksin zyrtar relevant të inflacionit të publikuar nga autoritetet publike kompetente të Kosovës;

Ndikimet potenciale të inflacionit të vlerësuar për vitet vijuese duke shfrytëzuar indeksin zyrtar relevant të inflacionit të publikuar nga autoritetet kompetente të Kosovës;

Progresin e bërë nga Ofruesi i Shërbimeve në arritjen dhe përmirësimin e Standardeve të Shërbimit;

Aspektet tjera të aktivitetit teknik, ekonomik dhe financiar të Ofruesit të Shërbimeve siç janë reduktimi i ujit që nuk sjell të hyra (humbjeve të ujit), riparimi i aseteve që shfrytëzohen për ofrimin e shërbimeve, rritjet e mëdha të popullatës që mbulohen nga shërbimi, rritjet në numrin e Konsumatorëve, rritjet në shkallën e faturimit dhe të inkasimit të Faturave, dhe kriteret tjera relevante, duke përfshirë ato të paraqitura në Rregullën për Treguesit Kyç të Punës;

Kostot relevante për ngritjen në nivel më të lartë të shëndetit publik, mbrojtjen e mjedisit dhe/ose standardet për planifikimin hapsinor;

Variacionet në nivelin e plotësimit të kërkesave të Konsumatorëve të anketuar nga Rregullatori dhe/ose nga entitetet tjera të cilat kryejnë studimet ose anketat mbi përmbushjen e kërkesave të Konsumatorëve;

Variacionet e kostove që kanë të bëjnë me masat e bëra për të siguruar furnizimin me ujë siç janë kostot për kërkimin e burimeve të reja të ujit;

Çfarëdo fakte tjera ose tregues të natyrës objektive të tilla si ato që kanë të bëjnë me rezultatet e punës së Ofruesit të Shërbimeve të matura nga Rregullatori nëpërmes krahasimit me Ofruesit tjerë të Shërbimeve me karakteristika të krahasueshme në ose jashtë Kosovës.

## **PJESA VIII: MARRËVESHJET PËR TARIFA**

### **Kapitulli 17: Negociatat dhe Lidhja e Marrëveshjes për Tarifa të Shërbimit**

#### **Neni 37: Marrëveshja për Tarifa të Shërbimit**

- 37.1. Rregullatori mund të lidhë marrëveshje me shkim me cilindo Ofrues të Shërbimeve me qëllim të ndryshimit, ndërrimit ose të plotësimit cilëso Tarifë të Shërbimit të vendosur në bazë të kësaj Rregull.
- 37.2. Marrëveshjet për Tarifa të Shërbimit mund të lidhen duke dhënë ndonjë kusht paraprak të përcaktuar nga Rregullatori dhe të propozuar tek Ofruesit e Shërbimeve, duke përfshirë, pa kufizime, lidhja e marrëveshjeve tjera me Ofruesit e Shërbimeve për:

- (a) Lëshimin, ripërtërirjen, zgjatjen, ndryshimin, ndërrimin dhe plotësimin e Standardeve të Shërbimit;
- (b) Lëshimin, ripërtërirjen, zgjatjen, ndryshimin, ndërrimin dhe plotësimin e Licencës së Shërbimit;
- (c) Zgjerimin e fushëveprimit territorial të Zonës së Shërbimit;
- (d) Zgjerimin, rehabilitimet e mëdha ose ndreqjet e duhura në Rrjetin e Ujit;
